



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji e Kërkimit Shkencor

Ngarkesa: 6kredite; 60 orë mësimore; 30 orë leksione / 30 orë seminare;

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Masteri “Mësuesi”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithsme lëndore:

Kjo lëndë zhvillon te studentët aftësinë: për të lexuar dhe analizuar në mënyrë kritike kërkimet shkencore të botuara në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe mësimdhënies; për të përzgjedhur dhe përdorur metodologjinë e duhur për të realizuar kërkimin shkencor në varësi të natyrës së çështjes që shtrihet për hulumtim; për të shtruar çështje, formuluar hipoteza, përcaktuar metodologjinë dhe instrumentet e duhura për mbledhjes e të dhënave; për të mbledhur, analizuar dhe interpretuar të dhëna sasiore dhe cilësore, duke përdorur teknika analitike të avancuara; për të zbatuar parimet etike në çdo fazë të kërkimit, duke siguruar që hulumtimi të jetë i përgjegjshëm dhe transparent; për të hartuar dhe realizuar punime shkencore me standarde ndërkombëtare, duke ndjekur të gjitha rregullat e citimit dhe të dokumentimit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të vlerësojnë në mënyrë kritike teoritë dhe metodat shkencore dhe të përzgjedhin metodën e përshtatshme për punimin e tyre;
2. Të analizojnë problematike në aspektin kërkimor dhe të gjejnë zgjidhje;
3. Të planifikojnë dhe zhvillojnë në mënyrë të pavarur projekte kërkimore, që nga krijimi i ideve deri tek publikimi.

Rezultatet të pritshme:

Ky kurs i njeh studentët me metodat e punës kërkimore të përdorura në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe në mënyrë të veçantë në kërkimet në gjuhën e huaj duke i pajisur ata me njohuri teorike dhe shprehje praktike për metodat e kërkimit, hartimit dhe përpilimit të një punimi shkencor. Në të trajtohen konceptualizimi dhe kryerja e kërkimit shkencor, parashtrimi i çështjeve të kërkimit, grumbullimi dhe mbledhja e të dhënave, përpunimin dhe analizimi i tyre si dhe shkrimi dhe raportimi i kërkimeve shkencore.